

THIRRJE PËR APLIKIM PËR PANELE SOLARE

Organizata “Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës” (IADK), është duke zbatuar projektin **“Transhumanca - ofertë e re turistike e Kosovës dhe Malit të Zi”** projekt 2 vjeçar (Shtator 2020 – Gusht 2022). Projekti është i financuar nga Bashkimi Evropian përmes programit IPA II të bashkëpunimit ndërkufitar në mes Malit të Zi dhe Kosovës. Partner në projekt janë IADK si partner udhëheqës, Komuna e Istogut dhe Regional Development Agency for Bjelasica, Komovi and Prokletije (RDA KBP) si bashkëaplikues. Komuna Istog dhe Pejë janë po ashtu bashkëfinancues të projektit.

Projekti ka për qëllim përmirësimin e vëllimit, cilësisë dhe dukshmërisë së turizmit në lidhje me vlerësimin e trashëgimisë dhe vlerave kulturore dhe natyrore, si dhe përfshirjen e transhumancës në ofertën e turizmit të Kosovës dhe Malit të Zi.

Në kuadër të aktiviteteve të projektit është planifikuar përkrahja e 50 familjeve që kanë stane/villa në bjeshkë me panele solare, 20 nga të cilat kanë kapacitet të madh (për TV, frigorifer etj) dhe 30 të kapacitetit të vogël (për mbushjen e GPS, telefonave, etj).

Andaj, ftohen të gjithë të interesuarit që të aplikojnë për mbështetjen me panele solare dhe paisje tjera për zhvillimin e turizmit malor në komunën e Istogut dhe Pejës.

KRITERET BAZË QË DUHET PLOTËSUAR KANDIDATËT JANË :

- Të jenë aktiv në veprimtarit bujqësore dhe turistike;
- Të kenë mundësi për t’u angazhuar në turizëm (tokë, uji, fuqi punëtore);
- Të kenë stane/villa që mund të akomodojnë turistë, dhe/apo të jenë në gjendje të ofrojnë shërbime turistike;
- Të kenë gatishmëri për pjesëmarrje në të gjitha aktivitetet për ngritje të kapaciteteve;
- Të kenë ide të krijojnë mundësi punësimi dhe gjenerim të të ardhurave në sektorin e turizmit;
- Të kenë vend atraktiv dhe të përshtatshëm për zhvillim të aktiviteteve turistike;
- Gratë dhe të rinjtë do të kenë prioritet në përzgjedhje.


Aplikacioni mund të merren në **zyrat e IADK-së, në zyrat e turizmit në komunat Istog dhe Pejë**, ose mund t’i kërkonit me anë të e-mail adresave: gonxhe.dobroschi@iadc.org apo egzon.gerxhaliu@iadc.org. Aplikacioni me dokumente përcjellëse duhet të dorëzohet në zyrat e IADK-së apo zyrat për turizëm në komunat përkatëse: Istog (person kontaktues Genc Ademaj) dhe Pejë (person kontaktues Virtyt Morina) ose në e-mailat e lartëcekura.

Aplikacionet duhet të dorëzohen deri me datën 26.03.2021 në ora 16:00.

Për informata shtesë mund të kontaktoni në +383 49 224 904 ose +383 49 777 046.

Singerisht,

Zenel Bunjaku
Drejtor Ekzekutiv



Ky projekt është i financuar
nga Bashkimi Evropian



MNE – KOS

PROGRAMI IPA I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR
MALI I ZI – KOSOVË 2014-2020